



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 201302834/9

Tiranë ___/___/2014

Lënda: *Rekomandojmë dërgimin për miratim tek Shefi i Shtabit të Përgjithshëm, të kërkesës së ushtarakut të dalë në rezervë N. B., për përfitim financiar me rastin e vdekjes të babait të tij*

Drejtuar: **Ministrisë së Mbrojtjes**
Drejtorit të Drejtorisë së Arsimit dhe Përkujdesjes Sociale të Ushtarakëve
Z. Kujtim KADZADEJ

Për Dijeni: **Shefit të Shtabit të Përgjithshëm**
Gjeneralmajor Jeronim BAZO

Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Mbrojtjes
Z. Arian KRAJA

I nderuar Z. Kadzadej,

Pranë Institucionit të Avokatit të Popullit ka paraqitur ankesë shtetasi N. B., ushtarak i dalë në rezervë, i cili ka shërbyer në Repartin Ushtarak Nr.3005. Ky shtetas pretendon se i është refuzuar pa të drejtë kërkesa për të përfituar ndihmë financiare me rastin e vdekjes të babait. Më konkretisht, ankuesi shpjegon se, në datën 25.09.2012 ka humbur jetën babai dhe në bazë të nenit 30 të Ligjit Nr. 9210, datë 23.03.2004 ai ka kërkuar ndihmë financiare duke dorëzuar edhe dokumentacion përkatës në komandë por, nuk ka marrë përgjigje.

Pas interesimit tonë në Komandën e Repartit Ushtarak Nr. 3005, jemi vënë në dijeni se, propozimi për dhënie e ndihmës financiare për ushtarakun N. B. i është përcjellë bashkë me dokumentacionin përkatës Drejtorisë së Përkujdesjes Sociale. Kjo drejtori, me shkresën Nr.12200/1, datë 26.12.2012, ka kthyer dokumentacionin me arsyetimin se:

- Praktika është dërguar përtej afatit kohor prej 5 ditësh nga dita e paraqitjes së kërkesës së ushtarakut për trajtim me ndihmë financiare të menjëhershme, në zbatim të pikës III të Udhëzimit Nr.4,

datë 21.03.2012, të Ministrit të Mbrojtjes “*Për procedurat e dhënies së ndihmës së menjëhershme financiare në rast sëmundje të rëndë e të gjatë, apo vdekje*”.

- Bazuar në Urdhërin Nr.1787, datë 18.10.2012 të Ministrit të Mbrojtjes, Major N. B., i janë ndërprerë marrëdhëniet financiare në datën 01.11.2012 dhe pas kësaj date ai nuk gëzon statusin për trajtim sipas nenit 30/2 të Ligjit Nr. 9210, datë 23.03.2004.

Nga analiza në tërësi e legjislacionit dhe dokumentacionit për dhënien e ndihmës financiare rezulton se, refuzimi i ndihmës financiare për shtetasin N. B. është bërë në kundërshtim me ligjin.

Neni 30/2 i Ligjit Nr. 9210, datë 23.03.2004 “*Për statusin e ushtarakut të FA*” përcakton se: “*Në rastet kur ushtarakut aktiv i vdes bashkëshorti/bashkëshortja ose një familjar në ngarkim të tij pëson sëmundje të rëndë e të gjatë ose vdes i jepet ndihmë financiare e menjëhershme në masën deri në tri paga mujore*”. Që ushtaraku të përfitojë ndihmë financiare në rastet kur i vdes një familjarë duhet që ai të jetë në marrëdhënie pune (ushtar aktiv) dhe që familjari të jetë në ngarkim të tij. Nga dokumentacioni që kemi në dispozicion rezulton se, ushtarakut N. B. i janë ndërprerë marrëdhëniet financiare në datën 01.11.2012 (Urdhëri Nr.1787, dt. 18.10.2012 i MM) dhe babi i tij ka ndërruar jetë në datën 25.09.2012 (çertifikata vdekjes). Kërkesa e ushtarakut N. B. për përfitimin financiar është protokolluar në datën 29.10.2012 dhe po në këtë datë ajo i është përcjellë bashkë me dokumentacionin përkatës Komandës të Forcës Ajrore. Pra, ushtaraku N. B. ka qenë në marrëdhënie pune në datën kur babai i tij ka ndërruar jetë dhe kur ai ka dorëzuar kërkesën për përfitimin financiar. Ligji nuk parashikon afate me kalimin e të cilave, ushtarakut i humb e drejta për përfitimin financiar. Afatet 5 ditore të përcaktuara në Udhëzimin Nr.4, datë 21.03.2012 “*Për procedurat e dhënies së ndihmës së menjëhershme financiare në rast sëmundje të rëndë e të gjatë, apo vdekje*”, janë afate që kanë të bëjnë me organizimin e punës të komandave dhe drejtorive të FA dhe Ministrisë së Mbrojtjes. Mosrespektimi i këtyre afateve nuk sjell humbjen e të drejtës të ushtarakut për përfitimin financiar. Referimi ligjor i Drejtorisë së Përkujdesjes Sociale është i gabuar.

Bashkëlidhur rekomandimit po ju dërgojmë fotokopje të praktikës për këtë rast.

Për sa më lart, bazuar në Nenin 63, pika 3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku thuhet se: “*Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut*” si dhe në mbështetje të Nenit 21/b të Ligjit Nr.8454 dt.04.02.1999 “*Për Avokatin e Popullit*” (me ndryshimet përkatëse) ku përcaktohet se: “*Avokati i Popullit paraqet rekomandime për marrje masash për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive.*”

J U R E K O M A N D O J M Ë:

Dërgimin për miratim tek Shefi i Shtabit të Përgjithshëm, të kërkesës së ushtarakut të dalë në rezervë N. B., për përfitim financiar me rastin e vdekjes të babait të tij.

Në bazë të Nenit 22 të Ligjit Nr.8454 dt.04.02.1999 "*Për Avokatin e Popullit*", lutemi të vihemi në dijeni brenda afatit 30 ditor për qëndrimin dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij rekomandimi.

Duke besuar në bashkëpunimin Tuaj,

AVOKATI I POPULLIT

Igli TOTOZANI

Me Urdhër dhe me Porosi

K O M I S I O N E R I

Arben SHKËMBI